

MODEL PËR RIINTEGRIMIN E TË MBIJETUARAVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE

2021



“Modeli për riintegrimin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore” është përgatitur nga organizata “Të Nryshëm & Të Barabartë” në kuadër të projektit “Mbështetja e Bashkive Tiranë, Elbasan dhe Vlorë në analizimin, përvetësimin dhe zbatimin e modeleve / skemave të reja për integrimin socio-ekonomik për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore”, në kuadër të Programit të Përbashkët të OKB-së “Fund Dhunës ndaj Grave”, financuar nga Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga UNDP, UW Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.

**Autor: Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E)
Tiranë, Shqipëri**



Contents

Shkurtime e përdorura.....	4
Hyrje.....	4
Fjalorth termash.....	7
koncepti i riintegritimit.....	12
Kreu I.....	13
Riintegrimi si proces me etapa/ faza.....	12
Kreu II.....	20
Reintegrimi si një plotësi shërbimesh që takojnë nevojat.....	20
Kreu III.....	23
Riintegrimi si qasje etike.....	23
Kreu IV.....	27
Ndryshimi i kontekstit.....	27
Kreu V.....	29
Partnershipe të rëndësishme për zbatimin e këtij modeli.....	29
Kreu VI.....	29
Kostoja e zbatimit të këtij modeli.....	29
Kreu VII.....	33
Dokumentacioni dhe formate të rëndësishme në zbatimin e modelit të riintegritimit.....	33
Kreu VIII	
Baza ligjore e Modelit.....	52

Shkurtime e përdorura

AP	Institucioni i Avokatit të Popullit
AKPA	Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
D&E	Të Ndryshëm & Të Barabartë
DR & ZVP	Drejtoritë Rajonale & Zyrat Vendore të Punësimit
DQOSHKSH	Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
DHBGJNG	Dhuna me bazë gjinore ndaj Gruas
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipet Teknike Ndërdisciplinore
KE	Komisioni Europian
KV	Koordinator Vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare
MDhBGj	Të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OShC	Organizatrat e Shoqërisë Civile
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
PPN	Plani i Përbashkët i Ndërhyrjes
PSH	Policia e Shtetit
REVALB	Sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.
SPZ	Specialistët e Policisë së Zonës
UM	Urdhri i i Mbrojtjes
UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
UMPMM	Urdhri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme
UMM	Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes

Hyrje

Modeli për riintegrimin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore (MDhBGj) është hartuar nga organizata “Të Nryshëm & Të Barabartë” (D&E) në kuadër të projektit “Mbështetja e Bashkive Tiranë, Elbasan dhe Vlorë në analizimin, përvetësimin dhe zbatimin e modeleve / skemave të reja për integrimin socio-ekonomik për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore”, në kuadër të Programit të Përbashkët të OKB-së “Fund Dhunës ndaj Grave”, financuar nga Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.

Projekti ka për qëllim të fuqizojë kapacitetet e institucioneve vendore, si dhe organizatave të shoqërisë civile në përshtatjen dhe zbatimin efektiv të modeleve për ri/integrimin socio-ekonomik të MDhBGj duke kontribuar direkt në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes, riintegrimin e fuqizimit afatgjatë të MDhBGj.

Ky model ka marrë në konsideratë praktikatat më të mira të organizatës D&E dhe partnerëve të saj në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë që janë udhëhequr dhe nuk bien ndesh me legjislacionin kombëtar shqiptar.

Hartimi i modelit u parapri nga, dhe u bazua në studimin “Riintegrimi i të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore” i cili hulumtoi në thellësi paketën e shërbimeve riintegruese për MDhBGjnë Bashkinë e Tiranës, Elbasanit dhe Vlorës si edhe evidentoi nevojat për zbatimin e modeleve riintegruese.

Modeli parashikon shërbime afatgjata të strukturuar dhe shumëdimensionale për MDhBGj, dhe aplikimin e qasjeve që sigurojnë riintegrimin dhe parandalojnë abuzimet e mëtejshme.

Modeli është hartuar për t’iu ardhur në ndihmë Bashkive për ndërtimin dhe zbatimin e planeve efikase të shërbimeve riintegruese për MDhBGj.

Ai mund të zbatohet në kushtet dhe me burimet që kanë vetë bashkitë dhe me aktivizimin prej tyre të profesionisteve e profesionistëve dhe institucioneve lokale dhe qendrore që ofrojnë shërbime direkte apo koordinojnë ndihmë, në cilësinë e pjestarëve të Ekipit Teknik Ndërdisiplinor të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.

Modeli presupozon që në rastet kur për arsye sigurie apo të tjera MDhBGj duhet të rifillojnë jetën e tyre në një bashki tjetër, koordinatorët vendorë për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (KVDhF-të) përkatës bashkëpunojnë për interesin më të lartë të MDhBGj dhe personave të tjerë të varur në kujdesin e tyre dhe të prekur prej lëvizjes, si fëmijët, persona në kujdestari zyrtarisht ose jo etj..

Profesionistet dhe profesionistët që mund t’i referohen këtij modeli janë: psikologët dhe psikologët që mund të jenë të punësuar pranë bashkive, organizatave jofitimprurëse, institucioneve shëndetësore, arsimore, në polici apo pranë qendrave komunitare;

punonjëset dhe punonjësit e kujdesit shëndetësor në nivel vendor, si mjeket/mjekët e familjes apo ato/ata të cilat/cilët punojnë në qendrat e shërbimit rezidencial apo komunitar përfshirë personelin shëndetësor që punon pranë organizatave jofitimprurëse; juristet/juristet të cilat/cilët ofrojnë shërbime pranë klinikave ligjore, Dhomës së Avokatisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Parësore; organizatave jofitimprurëse, qendrave komunitare, etj; punonjëset dhe punonjësit e policisë që punojnë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje (sektorine Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje, sektorin kundër trafikëve të paligjshme, në komisariate apo drejtori vendore, si dhe punonjësit e angazhuar për policimin në komunitet (SPZ-të); mësueset dhe mësuesit, specialiste/specialistë të tjerë edukimi si dhe të shërbimit psiko-social në sistemin arsimor të cilat/cilët punojnë në shkolla, në Drejtoritë Rajonale & Zyrat Vendore të Punësimit (DV & ZVP), në organizata jofitimprurëse, etj, punonjëset/punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve të angazhuar pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

Përshkrimi i Modelit është ndarë në 8 kapituj ku janë përfshirë: Riintegrimi si proces me etapa/ faza (I); Reintegrimi si një plotësi shërbimesh që takojnë nevojat (II); Riintegrimi si qasje jetike (III); Ndryshimi i kontekstit (IV); Partnershipe të rëndësishme për zbatimin e këtij modeli (V); Kostoja e zbatimit të këtij modeli (VI); Dokumentacioni dhe formate të rëndësishme në zbatimin e modelit të riintegritimit (VII); Baza ligjore e Modelit (VIII).

Fjalorth Termash

Dhunë – është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

Dhunë me bazë gjinore – është dhunë ndaj një personi për shkak të gjinisë së personit ose dhunë që prek më shumë personat e një gjinie të veçantë. Llojet e dhunës me bazë gjinore përfshijnë dhunën në familje, presionin dhe intimidimin seksual, prerjet e organeve gjentile femërore¹, martesat e detyruara, dhunën online.²

Dhunë me bazë gjinore kundër gruas është çdo lloj dhune e drejtuar ndaj gruas sepse është grua ose dhunë që prek më shumë gratë³

Dhunë ndaj grave – është, siç e përcakton “Deklarata e Kombeve të Bashkuara “Për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave”, “çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell ose ka gjasa të sjellë lëndime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, përfshirë edhe kanosjet për akte të tilla, shtrëngime apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private”.

Dhunë në familje – është çdo akt dhune, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Dhunues – është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

Dhunë ekonomike – janë veprime të kontrollit dhe monitorimit të sjelljes së një Rasti në terma të përdorimit dhe shpërndarjes së parave, dhe kërcënim i konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike. (Instituti European për Barazinë Gjinore, 2019)⁴

Dhunë fizike – çdo akt që shkakton lëndim fizik si rezultat i përdorimit të paligjshëm të forcës fizike. Dhuna fizike mund të marrë formën e, ndërmjet të tjerave, të sulmit të rëndë dhe të vogël, heqje e lirisë dhe të sulmit me armë”. (Instituti European për Barazinë Gjinore, 2019)

¹ Njihet ndryshe si FGM- Female Genital Mutilation

² ec.europa.eu

³ The Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence (Istanbul Convention)

⁴ Instituti European për Barazinë Gjinore (2019), marrë nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1096>

Dhunë psikologjike – çdo akt që shkakton dëm psikologjik tek një individ. Dhuna psikologjike mund të marrë formën e, për shembull, shtrëngimit, shpifjes, fyerjes me fjalë ose ngacmimit”.(Instituti Europian për Barazinë Gjinore, 2019)

Dhunë seksuale – konsiderohet çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose prekje seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë.

Përndjekje – është kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllim për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi me të cilët ka lidhje shpirtërore, apo për t’i detyruar ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës. (Neni 121/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë - shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012)

“Menaxhimi i rastit” në kontekstin e kujdesit shoqëror është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre – (sipas Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”⁵)

“Menaxhimi i rastit” në kontekstin e mbrojtjes së fëmijës është metodologjia që siguron, hap pas hapi, ofrimin në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive të ndihmës për fëmijën në nevojë për mbrojtje dhe që synon të promovojë e të nxisë më tej mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e tij – (sipas VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”⁶). Neni 5 i së njëjtës VKM përmban hapat e menaxhimit të rastit në rast të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të cilat janë: 1. Identifikimi; 2. Raportimi; 3. Vlerësimi fillestar; 5. Zhvillimi i Planit Individual të Mbrojtjes 6. Implementimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM (Plani Individual i Mbrojtjes); 7. Mbyllja e rastit.

“Menaxhim i rastit” në kontekstin e të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, është veprimtaria efektive që siguron ndihmën e mbështetjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, me qëllim mbrojtjen, garantimin e të drejtave dhe rehabilitimin e tyre – (sipas VKM nr. 327, date 2.6.2021 Për Mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës).

⁵Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë,
<https://shendetesia.gov.al/ligje-7/>

⁶VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes, <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>

Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje krijohet pranë çdo bashkie dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga: a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) ekipet teknike ndërdisiplinore (në vijim, ETN); c) koordinatorët vendorë (në vijim, KV).⁷

Ekipi Teknik Ndërdisiplinor (ETN) – janë anëtarët të cilët emërohen nga Komiteti Drejtues i – MKR-së dhe janë përfaqësues teknikë të institucioneve anëtare të Komitetit Drejtues si dhe ofrojnë shërbime dhe mbështetje për të mbijetuarat e dhunës në familje në përputhje me mandatin e tyre përkatës.

REVALB – është sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.

Vlerësimi i riskut – është ajo fazë e menaxhimit të rastit të dhunës në familje, që kryhet në mënyrë të shpejtë, menjëherë pas identifikimit ose raportimit të rastit, me qëllim ndalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm të dhunës dhe mbrojtjen e viktimës përmes Urdhërit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.

Urdhër mbrojtjeje – është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje – është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme – është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykatat

Shërbime të kujdesit shoqëror – është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.⁸(Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

⁷v e n d i m nr. 327, datë 2.06.2021 për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës

Shërbime rezidenciale – janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Shërbime komunitare – janë shërbime që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditë apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Shërbime parashoqërore – janë shërbime që përfshijnë informimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga ofruesit e shërbimeve, ndihmën për përfituesit në përcaktimin e nevojave të tyre, vlerësimin fillestar, mbështetjen dhe ndihmën për zgjedhjen që u përshtatet nevojave të përfituesit në sistemin e shërbimeve shoqërore. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Shërbime në familje – janë shërbime të kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Shërbime të specializuara – janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonar dhe bashkie për fëmijët me çrregulime përvazhë të zhvillimit, prapambetje mendore, çrregullime në komunikim, në nevojë për aftësim fizik, fëmijët e abuzuar seksualisht, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara apo të trafikuar, si dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line – është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së Fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Përfitues i shërbimeve të kujdesit shoqëror – është subjekti, Rasti ose familja që përmbush kushtet për të përfituar të drejtat nga shërbimi shoqëror. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Punonjës i shërbimeve sociale – është i punësuar në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Njësi të qeverisjes vendore – janë bashkitë dhe qarqet, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Punonjës social i njësisë së qeverisjes vendore – është profesionisti, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jetë përgjegjës për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve. (Ligji Nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”)

Koncepti i Riintegrit

Riintegrimi i rastit MDhBGj në këtë Model është një proces i mbështetjes profesionale multidimensionale dhe arritjes së shëndetit dhe mirëqenies së plotë të rastit pas eksperincave të dhunës me bazë gjinore.

Riintegrimi në këtë Model është një koncept kompleks. Ai është:

Një proces me etapa / faza që ka për qëllim arritjen e gjendjes finale: Rasti MDhBGj, autoritetet dhe profesionistët përgjegjës dhe të angazhuar investohen në mënyrë të planifikuar dhe të strukturuar për të ndryshuar situatën dhe arritur gjendjen finale.

Një plotësi shërbimesh që takojnë nevojat: Rasti MDhBGj mbështetet në nevojat ekonomike sociale, ligjore etj..

Një mënyrë qasjeje dhe të punuari: gjendja finale e synuar, shërbimet e dhëna, procesi merr në konsideratë dhe aplikon parimet e informimit mbi traumën, përfshirjes së familjes, fuqizimit, trajtimit multidisiplinar nën drejtimin e një menaxheri rasti .

Një gjendje finale e synuar dhe e arritur : Rasti MDhBGj i ka zgjidhur të gjitha problemet e shëndetit⁹ të lidhura me dhunën dhe është në gjendje të parandalojë dhe të zgjidhë vetë problemet që i dalin.

Një marrëdhënie e ndërsjellë: Rasti MDhBGj, autoritetet dhe profesionistët përgjegjës dhe të angazhuar reflektojnë njëri- tjetrin dhe i përshtaten njëri-tjetrin në veprime dhe rezultate.


Një ndryshim i kushtëzuar prej sigurisë: Rasti MDhBGj, autoritetet dhe profesionistët duhet të ndryshojnë komunitetin, akomodimin, kontaktet, komunikimin për të mënjatur rreziqet e sigurisë.

Një ndryshim i ambientit me qëllim lehtësimin e rikuperimit: Autoritetet dhe profesionistët bëjnë veprime për të ndryshuar kontekstin ambientin ku vepron rasti MDhBGj.

⁹Koncepti I shëndetit sipas përkufizimit të OBSH-së

KREU I

Riintegrimi si proces me faza/ etapa/ faza



Faza I: Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize

Vlerësimi dhe reduktimi i rrezikut – Vetëvlerësimi i rrezikut dhe largimi nga rreziku

Vlerësimi i rrezikut shërben për të përcaktuar se ku dhe me çfarë shërbimesh/ veprimesh duhet të fillojë riintegrimi. Masat për reduktimin e rrezikut përveçse janë një e drejtë, shërbejnë si bazë për etapa të tjera.

- **Etapa për Profesionistët – Vlerësimi dhe Reduktimi i rrezikut**

Një rast i dhunës në familje konsiderohet “urgjent” kur dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e personit¹⁰ Në matjen e rrezikut në rastet e dhunës në familje konsiderohen: plagët si rezultat i dhunës; frika; mendimi që dhunuesi mund t’i bëjë keq fëmijëve; izolimi nga familja miqtë; depresioni; idetë për vetëvrasje; konfliktet lidhur me fëmijët; konteksti në të cilin përshkallëzohet dhuna; shpëstësia e incidenteve; kontrolli; përdorimi i armëve dhe objekteve; kërcënimet etj..

Në rastin e trafikimit, matja ka të bëjë edhe me nivelin e rrezikut edhe me burimet e tij. Për matjen në këto raste është e rëndësishme të matet: përfshirja e familjarëve në trafikim, mënyra e identifikimit, bashkëpunimi, përfshirja e trafikantit në veprimtari të tjera kriminale apo grupe kriminale etj..

Masat për reduktimin e rrezikut duhet të marrin në konsideratë: nivelin e rrezikut real dhe të perceptuar, zgjedhjet e Rastit për ambjentin e qëndrimit, perspektivën e ndryshimit të nivelit të rrezikut, vullnetin për bashkëpunimin me autoritetet e zbatimit të ligjit, masat e marra ndaj shkelësit, etj..

Masat për reduktimin e rrezikut real dhe të perceptuar përfshijnë: informimin për të drejtat, transportin e sigurt, akomodimin në një qendër të sigurt/ të ruajtur, mbështetjen për pjesëmarrje në procedurat ligjore të hetimit të dhunuesit/ dhunuesve, caktim të një punonjësi rasti (koordinatore lokale kunder dhunës në familje ose punonjësja e njësisë administrative e caktuar), planifikim i menaxhimit të rrezikut, mbështetje psikologjike për krizën, trajtim shëndetësor për problemet e urgjencës, plotësim i nevojave bazë.

¹⁰“Rast urgjent”, rasti kur dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e personit dhe merren masa paraprake të menjëhershme për mbrojtjen e viktimave, për ndalimin e dhunës dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të saj -v e n d i m nr. 327, datë 2.06.2021 për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës

- **Etapa për rastet – Vetëvlerësimi i Rrezikut Largimi nga rreziku**

Rastet duhet të kuptojnë se: matja e saktë e rrezikut mbështetet kryesisht në vullnetin për ndarjen e informacionit dhe në sasinë e informacionit të ndarë; matja e rrezikut është një detyrim procedural për profesionistët; përpjekjet për të justifikuar sjelljet e dhunuesit mund të rrisin rreziqet; viktimave të veprës penale iu ulet dënimi ose janë të përjashtuar nga dënimi për vepra të kryera në shfrytëzim.

Në këtë etapë, rastet MDhBGj pritet që: të zgjedhin formën e akomodimit më të përshtatshme; të ndjekin udhëzimet për transportin dhe akomodimin; të njoftojnë për çdo rrezik apo ndryshim të nivelit të rrezikut; të japin opinionin e tyre lidhur me punonjësin e rastit.

- **Treguesit e suksesit/ mbylljes së etapës**

Siguria	Personat që e rrezikojnë nuk kanë akses tek rasti MDhBGj
Shëndeti fizik	Problemet e shëndetit fizik të lidhura me dhunën janë zgjidhur ose janë në rrugë zgjidhje
Shëndeti emocional dhe mendor	Rasti është i stabilizuar emocionalisht Rasti ndjehet i sigurt Rasti me probleme të shëndetit mendor është diagnostikuar dhe po merr mjekim rregullisht
Situata Sociale	Rasti ka marrëdhënie të mira sociale
Situata familjare	Fëmijët janë bashkë me rastin MDhBGj / Rasti MDhBGj është i qetë për fëmijët
Strehimi	Rasti është akomoduar në qendra dhe shtëpi të sigurta
Shëndeti ligjor	Rasti MDhBGj ka marrë vendim lidhur me procedurat ligjore Procedurat ligjore po vijnë pa rrezik për Rastin
Planet për të ardhmen	Rasti ka vendosur marrëdhënie të mira dhe ka filluar të ndajë informacion me punonjësin e rastit

- Mjete dhe kushte të nevojshme: Instrumente të matjes së rrezikut, qendra dhe shtëpi të sigurta
- Dokumentacioni i lidhur me fazën: Vlerësimi i menjëhershëm i nevojave (formularët); Marrëveshje midis rastit MDhBGj dhe institucionit për përfshirjen në procesin e ndihmës, riintegrimin;

Faza II: Asistenca afatmesme. Tranzicioni

Mbështetja e zhvillimit – Eksplorimi dhe zhvillimi i mekanizmave mbrojtës dhe funksionimit të pavarur

- **Etapa për Profesionistët – Mbështetja e zhvillimit**

Puna e profesionistëve në këtë etapë konsiston në vlerësimin e thelluar, planifikimin dhe përgatitjen e rastit MDhBGj për funksionim të pavarur në të gjitha aspektet. Veprimet udhëhiqen nga Menaxheri i Rastit/Koordinatori i DHBGJ. Rradha e veprimeve është: vlerësimi i thelluar; planifikimi; aplikimi i planit. Në fillim, menaxheri i rastit informon rastin MDhBGj për nevojën e vlerësimit dhe planifikimit dhe kërkon aprovimin e rastit për vlerësimet prej secilit prej profesionistëve të grupit multidisiplinar. Më pas pjestarët e grupit multidisiplinar bëjnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të shëndetit¹¹ Menaxheri i rastit mbledh vlerësimet dhe plotëson pjesët në lidhje me formimin profesional, punësimin, marrëdhëniet familjare dhe strehimin¹² dhe ia vë në dispozicion rastit për të ndërtuar së bashku planin e riintegrit. Me rënien dakord për planin, menaxheri i rastit koordinon veprimet për aplikimin e planit.

Veprimet e profesionistëve përfshijnë plotësimin direkt ose ndërmjetësimin për plotësimin e nevojave bazë – ushqim, veshje, mjekim, strehim, shoqërimet në institucione, asistencë në plotësim dokumentacioni, konsulta, këshillime, terapi etj..

- **Etapa për rastet MDhBGj – Eksplorimi dhe zhvillimi i mekanizmave mbrojtës dhe funksionimit të pavarur**

Për rastin kjo etapë konsiston në: rol aktiv në marrjen e informacionit për procesin; kërkimin që të merren në konsideratë dëshirat; korrektesën në takime e konsulta; kryerjen e detyrave të lëna / të rëna dakord me profesionistët; ndarjen e shqetësimeve dhe pakënaqësive mbi procesin; bashkëpunimin; ruajtjen e dokumentacionit të ndarë; respektimin e rregullave të konfidencialitetit, privatësisë etj..

- **Treguesit e suksesit/ mbylljes së etapës**

Siguria	Rasti është në gjendje të shmangë rreziqet që mund t'i dalin
Shëndeti fizik	Rasti nuk ka probleme serioze të shëndetit fizik

¹¹Vlerësimet e vecanta duhet të jenë së paku: vlerësimi shëndetësor nga mjeku, vlerësimi psiko-social nga psikologu, vlerësimi ligjor nga avokati, vlerësimi i nevojave për arsim nga një mësues

¹²Nëse është e mundur, Menaxheri i rastit mund të kërkojë konsultim nga specialist të formimit profesional, punësimit, strehimit

	Rasti është i pajisur me ilaçe, mjete për problemet kronike të shëndetit
Shëndeti emocional dhe mendor	Rasti ka përfunduar në mënyrë të suksesshme terapitë Vlerësimet psikologjike apo psikiatrike nuk rezultojnë në probleme të shëndetit
Situata Sociale	Rasti ka marrëdhënie të mira sociale
Situata familjare	Rasti ka rivendosur marrëdhënie të shëndetshme me familjen
Strehimi	Rasti ka bërë një plan afatgjatë strehimi Ka filluar procesi i strehimit afatgjatë Është gjetur një strehim dhe burimet e përballimit të strehimit
Shëndeti ligjor	Është i pajisur me dokumentat e nevojshme Procedurat ligjore kanë përfunduar ose po vijojnë pa rrezik për rastin MDhBGj
Aftësitë për jetën	Është në gjendje të jetojë vetëm
Edukimi Profesional	Ka përfunduar formim profesional
Arsimi	Ka rinisur shkollën Fëmijët janë në shkollë, ndjekin rregullisht shkollën
Punësimi	Ka filluar punë dhe tregon interes për ta mbajtur punën
Planet për të ardhmen	Shfaq interes të zgjerorë objektivat e planit

- Mjete dhe kushte të nevojshme: Qendra të sigurta
- Dokumentacioni i lidhur me fazën: Plani i Përbashkët i Ndërhyrjes (PPN), Plani i Ndihmës

Faza III: Asistenca afatgjatë dhe përfshirja sociale

Mbështetja e ndërtimit të pavarësisë – Ndërtimi i pavarësisë

- **Etapa për profesionistët – Mbështetja e ndërtimit të pavarësisë**

Puna e profesionistëve në këtë etapë konsiston në mbështetjen e funksionimit të rastit MDhBGj që jeton vetëm ose me familjarët. Mbështetja përfshin: mbështetjen financiare për qeranë; mbështetjen për zgjidhjen e çështjeve administrative; dhënien e informacionit dhe orientimin në institucione dhe procedura të ndryshme lidhur me shkollimin e fëmijëve, ndihmat materiale dhe përfitime të ndryshme; seanca këshillimi sipas nevojave. Kontaktet e menaxherit të rastit në këtë etapë quhen përmbledhtas “monitorim” dhe realizohet kudo ku individët jetojnë: në apartamente me qera, në familjen e origjinës dhe /apo familje kujdestare.

- **Etapa për individët: Ndërtimi i pavarësisë**

Për rastin MDhBGj kjo etapë konsiston në: Menaxhimin e marrëdhënieve sociale në ambjentin e punës; zgjidhjen e problemeve të përditshme; kujdesin pa ndihmë për fëmijët; marrjen e masave për parandalimin e rrezikut për fëmijët; menaxhimin e të ardhurave nga puna; krijimin e marrëdhënieve të reja sociale dhe rrethit të mbështetjes; ruajtjen e vetëvlerësimit dhe motivimit për progres

- **Treguesit e suksesit/ mbylljes së etapës**

Siguria	Rasti ka shmangur rreziqet që i kanë dalë
Shëndeti fizik	Rasti nuk ka probleme serioze të shëndetit fizik Rasti ka përballuar vetë blerjen e ilaçeve Rasti di ku të drejtohet për probleme të shëndetit Rasti është i siguar
Shëndeti emocional dhe mendor	Rasti di të diktojë situatat në të cilat duhet të drejtohet tek mjeku Rasti njeh sistemin e referimit të shëndetit mendor
Situata ekonomike	Rasti nuk ka borxhe
Situata Sociale	Rasti ka marrëdhënie të mira sociale
Situata familjare	Rasti ka rivendosur marrëdhënie të shëndetshme me familjen
Strehimi	Rasti përballon vetë strehimin ose është në një skemë të qëndrueshme të mbështetjes së strehimit
Shëndeti ligjor	Rasti nuk ka probleme me ligjin
Aftësitë për jetën	Rasti është në gjendje të menaxhojë paratë të ruajë higjenën
Edukimi	Rasti mund të përballojë ose të orientohet në formim profesional

Profesional	
Arsimi	Fëmijët janë në shkollë, ndjekin rregullisht shkollën
Punësimi	Ka filluar punë dhe tregon interes për ta mbajtur punën
Të ardhurat	Rasti ka të ardhura të mjaftueshme të bëjë një jetë normale
Planet për të ardhmen	Planet për të ardhmen bëhen duke llogaritur vetëm veten

- Mjete dhe kushte të nevojshme: Mjete Transporti, Mjete komunikimi
- Dokumentacioni i lidhur me fazën: Marrëveshje për mbështetjen

Mbështetja e shkëputjes – Shkëputja

- ***Etapa për profesionistët – Mbështetja e shkëputjes***

Puna e profesionistëve në këtë etapë konsiston në: organizimin e një takimi “ndarjeje “ me Rastin;¹³ reagimet etike në rast takimi rastësor; shqyrtimi dhe plotësimi i kërkesave të reja për ndihmë në rast të ndryshimit të situatës apo ngjarje të papërbalueshme¹⁴; përgjigjja adekuate në rast interesi apo kërkesë për informacion nga palë të treta

- ***Etapa për rastet MDhBGj***

Veprimet e individëve në këtë etapë janë të ngjashme me ato të individëve të komunitetit

- Mjete dhe kushte të nevojshme: Udhëzues i organizatës / Agjencisë
- Dokumentacioni i lidhur me fazën: Proces verbal i mbylljes së rastit

¹³në takim vendoset mënyra e komunikimit në rast nevojë , diskutohet mënyra e reagimit në raste të takimeve rastësore interesat e Rastit për të kontribuar në ndihmën për individë të tjerë.

¹⁴Humbja e punës, sëmundje

KREU II

Reintegrimi si një plotësi shërbimesh që takojnë nevojat

Akomodimi i sigurt dhe i përshtatshëm

Ligji kërkon që kur është e domosdoshme punonjësit e policisë në bashkëpunim me Koordinator/en Vendor/e kundër dhunës në familje (KVDHF) duhet të mundësojnë strehimin e të mbijetuarës DHBGJ si dhe të fëmijëve të saj në një strehëz emergjente, strehëz afatgjatë apo në hapësira të tjera të sigurta, për të cilat anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në Bashkinë përkatëse kanë vendosur që të përdoren si alternativa për strehime të sigurta. Në këto raste duhet të merret parasyshvullneti i të mbijetuarës DHBGJ për t'u strehuar dhe standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra. Ligji kërkon që t'u jepet prioritet alternativave sa më pranë vendbanimit të të mbijetuarës DHBGJ dhe në mungesë të mbështetjes nga ana e tyre të zgjidhen strehëzat në Tiranë.

Siguria dhe mbrojtja

Në rastin kur në respektim të vullnetit të të mbijetuarës DHBGJ dhe interesit më të lartë të të miturve, rasti strehohet pranë familjarëve të saj, ose në një banesë të dytë në një qytet tjetër, policia monitoron rastin e dhunës në familje duke garantuar sigurinë e përfitueses dhe/ose të familjarëve të saj. Në rast se e mbijetuara e dhunës në familje strehohet në një banesë në një qytet tjetër, njoftohen menjëherë strukturat përkatëse të policisë si edhe KVDHF për monitorimin e rastit dhe garantimin e sigurisë së viktimës, fëmijëve në varësi dhe familjarëve/të afërmeve ku po strehohet.

Informacioni dhe Mbështetja ligjore

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka parashikuar se ndër kategoritë e veçanta që përfitojnë nga shërbimet ligjore falas pavarësisht nëse e përmbushin apo jo kriterin e pamundësisë ekonomike janë edhe viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzimit seksual, të miturit viktimat dhe në konflikt me ligjin¹⁵. Ligji parashikon tre forma/lloje ndihme: Ndhimë juridike parësore; Ndhimë juridike dytësore; Përrjashtim nga taksat dhe tarifat gjyqësore. Ndhimë juridike parësore ofrohet nga: Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore që janë zyra të ngritura me qëllim ofrimin e këshillimit dhe dhënien e orientimeve ligjore falas; Klinikat e ligjit pranë Institucioneve të arsimit të lartë që janë zyra të ngritura pranë fakulteteve me qëllim ofrimin e këshillimit dhe dhënien e orientimeve ligjore falas; Organizatat jofitimprurëse (OJF) të autorizuara që janë organizata të cilat ofrojnë shërbim ligjor falas, pas marrjes së autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e këtij shërbimi.

¹⁵Neni 11 i ligjit

Strehimi afatgjatë

Sipas Ligjit nr. 22/2018 për strehimin social në programet sociale të strehimit përfshihen: a) programi i banesave sociale me qira; b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim; ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; d) programi për krijimin e banesave të përkohshme; dh) programi i banesave të specializuara. Në Nenin 16 të ligjit, “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”, përcaktohet se u jepet përparësi të mbijetuarave të e dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit.

Kujdesi për shëndetin fizik

Nëse nga dhuna e ushtruar e mbijetuara e DHBGJ ka dëmtime në shëndet, duhet patjetër të drejtohet në njësinë vendore të kujdesit shëndetësor apo në spitalin më të afërt për të marrë shërbimet shëndetësore që i nevojiten. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor ose në spitalin më të afërt, rasti kryen vizitën, merr trajtimin e nevojshëm mjekësor, mbështetje psikologjike dhe pajiset me raportin mjekësor, i cili përbën një provë të rëndësishme gjatë procesit të kërkimit të lëshimit të urdhërave të mbrojtjes.

Vlerësimi i shëndetit fizik, duhet të bëhet pjesë e vlerësimit për çdo rast. Ai duhet të bëhet nga personeli mjekësor dhe bazuar në këtë vlerësim kryer vizitat, analizat dhe trajtimet e nevojshme mjekësore.

Mbështetja psikologjike

Nëse nevojiten shërbime psikologjike, atëherë punonjësi i policisë dhe KVDHF kontaktojnë me psikologët e bashkisë, shkollave, Linjën Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza në numrin pa pagesë 116117, anëtarët e MKR-së të specializuar në ofrimin e një shërbimi të tillë, organizata të tjera të licensuara për ofrimin e shërbimit psiko-social falas, ose me Urdhërin e Psikologut, për të siguruar shërbimin e kërkuar.

Një profesionist psikolog duhet të jetë pjesë e konsultimeve për hartimin e Planit të Riintegritimit dhe e zbatimit të këtij plani. Seancat e këshillimit duhet të jenë specifike për secilin rast në përputhje me objektivat e përcaktuara në plan. Vendosja e qëllimit për seancat e këshillimit realizohet me mbështetjen e të dy palëve. Qëllimet që drejtojnë seancat e këshillimit psikologjik konsistojnë kryesisht në: stabilizimin gjendjes emocionale; teknikat për rritjen e vetëbesimit / vetëvlerësimit, trajtimin e episodeve traumatike të jetës dhe njohja e emocioneve që përshkojnë këto episode; vënien në dukje të pikave të forta; marrëdhëniet ndërpersonale; planet për të ardhmen; aftësitë praktike për jetën; çështjet e komunikimit; marrja e vendimeve / orientimi drejt vendimmarrjes; qëndrueshmëria në marrëdhëniet e punës (rritja e përgjegjësisë, korrektësisë, kuptimit të nevojës për punë), etj.

Edukimi dhe trajnimi profesional

Të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, rastet e trafikimit dhe dhunës në familje, nënat e reja nën moshën 18 vjeç bëjnë pjesë tek grupet e veçanta dhe përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit¹⁶ përfshirë edhe programe të nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit profesional¹⁷

Shërbimet e lidhura me formimin profesional, veçanërisht kur ato janë në përputhje me dëshirat dhe aftësitë individuale të MDHBGJ-ve, janë thelbësore dhe shërbejnë si garanci për një punësim të qëndrueshëm. Shërbimet që mund të përdoren janë ato të Qendrave Publike të Formimit Profesional. Individët duhet të mbështeten gjatë gjithë procesit të trajnimit profesional për vështirësitë që mund të hasin. Regjistrimi në më shumë se një kurs profesional nëse është e mundur, kontribuon në zgjerimin e aftësive për jetën dhe ndihmon për të kuptuar më mirë prirjet dhe interesat.

Punësimi dhe fuqizimi ekonomik

Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave dhe punësimi i tyre është faktor thelbësor në përballimin e shkaqeve bazë, të mundshme, të dhunës, varfërisë dhe mungesës së mjeteve ekonomike. MDHBGJ-të mbështeten hap pas hapi në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun e punës, nëpërmjet këshillimit për punësim dhe zhvillimin e karrierës. Në seanca individuale dhe grupi mësohen aftësi praktike se si të shkruhet një CV, një letër interesi, si të përgatitesh për një intervistë pune. Është e rëndësishme që mbështetja të vazhdojë deri në punësimin e qëndrueshëm, kryerjen e një internshipi me pagesë apo hapjen e një biznesi të tyre.

Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij kanë mundësuar programe për nxitjen e punësimit që mund të lehtësojnë procesin e ri/integrimit. Të rëndësishme janë: Programe të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” – VKM Nr.17 datë 15.01.2020; Programe të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit” - VKM Nr. 348, datë 29.4.2020; Programi i punëve publike në komunitet - VKM Nr. 535 datë 08.07.2020. Dy skema mbështetëse nga mund të përfitohet janë “Mbështetje për sipërmarrjet e vogla” dhe “Skema e Biznesit Social”.

¹⁶Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”

¹⁷neni 12 i ligjit

KREU III

Riintegrimi si qasje etike

Shërbime që marrin parasysh traumën

MDhBGj kanë patur eksperiencë traumatike. Këto eksperiencë ndikojnë emocionet, marrëdhëniet me të tjerët, mund të kenë efekt për tërë jetën dhe të jenë shkaktarë për probleme të shëndetit mendor. Ofruesit e shërbimeve për MDHBJ duhet të kenë kujdes që të mos i ritraumatizojnë individët, të mos i fajësojnë për mënyrën se si përpiqen të menaxhojnë reagimet e tyre dhe të japin mesazhin që ka shpresë për shërim. Rastet MDhBGj duhet që, në fakt, të përgëzohen që ia kanë dalë, i kanë mbijetuar situatave traumatike.

Përfshirja e familjes në ndihmë

Mirëqenia e fëmijëve është shqetësimi kryesor i MDhBGj. Ekspozimi i fëmijëve tek dhuna, ndryshimet në vendbanim, të shkollës, largësia prej të afërmeve, bullizmi në shkollë dhe në lagje, humbja e shokëve, veshja, ushqim, mbarëvajtja në mësim, realizimi i talenteve të tyre janë nevojat që duhen prioritetuar në trajtimin e MDhBGj sepse ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Adresimi i nevojave të fëmijëve duhet bërë në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në bashki.

“Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër”.

“Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër” është alternativë kujdesi nga profesionistë për fëmijët në një ambjent që ngjan me shtëpinë në kohën kur prindërit janë në punë me orare të zgjatura ose punojnë të shtunave.

Qëllimi është kujdesi për fëmijët dhe parandalimi i situatave shoqërore dhe të punësimit për nënat që mund të ndikojnë negativisht në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe për të ndihmuar nënat që të luajnë plotësisht rolin e tyre në familje.

Shërbimet dhe mundësitë e ofruara në alternativën e kujdesit " Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër " përfshijnë:

- Kujdesi dhe mbikëqyrja e fëmijëve nga një i rritur i përgjegjshëm
- Higjiena dhe shëndeti
- Ushqimi dhe ushqyerja
- Mbështetje për shkollën / detyrat e shtëpisë
- Mbështetje emocionale dhe mësimi i sjelljeve pozitive sociale
- Lojëra për fëmijë
- Informimi i nënës dhe konsultimi me të lidhur me kujdesin për fëmijën
- Observimi i sjelljeve të fëmijës dhe raportimi i dyshimeve për neglizhim, abuzim

apo ekspozim tek dhuna

- Vlerësimi dhe mbështetja psikologjike
- Vlerësimi dhe mbështetja mjekësore

Disa shërbime dhe mundësi ofrohen jashtë qendrës duke përfshirë vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e kujdesit, transportin për në..., shëtitjet e kohës së lirë, referimin e nënës dhe fëmijës për vlerësimin dhe trajtimin e nevojshëm dhe mbështetje për prindërimin.

Burimi: Të Ndryshë & Të Barabartë (2019) “Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër”, Tirana: Të Ndryshëm & Të Barabartë. Në dispozicion në: <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2020/05/E-fundit-Shtepia-e-gjyshes-ose-shtepia-tjeter-libri-shqip-Ok.pdf>

Trajtimi multidisiplinar

Puna për riintegrimin e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore realizohet nëpërmjet një përjasje multidisiplinare. Mbështetja reinte-gruese duhet të vijë nga një ekip që ka të paktën punonjës social, psikolog, jurist, doktor, dhe mësues. Një përbërje e tillë është e siguar në Ekipin Teknik Ndërdisiplinor (ETN). Anëtarët ETN, janë përfaqësues teknikë të institucioneve anëtare të Komitetit Drejtues, që ofrojnë shërbime dhe mbështetje në përputhje me mandatin e tyre përkatës. ETN-ja, në bashkëpunim me grupin teknik ndërdisiplinor për të drejtat e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta rast pas rasti, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Strukturim i përpjekjeve si menaxhim rasti

Sipas VKM 499 –PSV për viktimat e trafikimit¹⁸“Menaxheri i rastit” është një punonjës social, psikolog ose staf i trajnuar i caktuar me qëllim dhënien e ndihmës dhe ndërmjetësimin për ndihmë për personat e trafikuar qëvepron brenda një grupi këshillimor me profesionistë të tjerë, kur duhet të merren vendime mbi planin e përkujdesjes për secilin person. Menaxheri i rastit, në rastin e një të mituri të dyshuar si i trafikuar ose të identifikuar si i/e trafikuar nga G/SPIF është punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në njësinë vendore ku asistohet rasti, dhe/ose punonjësi social i qendrës pritëse apo rehabilituese për viktimat e trafikimit.

¹⁸VKM 499, datë 29.8.2018 PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT, <https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/PROCEDURAT-STANDARDE-T%C3%8B-VEPRIMIT-PER-MBROJTJEN-E-VIKTIMAVE-TE-TRAFIKIMIT.pdf>

“Menaxheri i rastit” në rastet e dhunës në familje është Koordinator/ja Vendore kundër Dhunës në Familje.“

(KVDHF) udhëheq e koordinon punën dhe shërbimet e ETN-së për të referuar dhe për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Gjithashtu, fillon, organizon dhe koordinon takimet e ETN-së, informon KD-në për punën e ETN-së dhe koordinon veprimet e institucioneve vendore dhe referimin e rasteve të dhunës në familje.

Puna me mentorë

Mentorimi është një shërbim shumë i rëndësishëm dhe i domosdomshëm për të ndihmuar MDHBGJ-të për të ndërtuar një rrjet social të besueshëm dhe të sigurt. Mentorimi është një proces në të cilin një individ me përvojë ndihmon një person tjetër të zhvillojë qëllimet dhe aftësitë e tij nëpërmjet një sërë bisedash të kufizuara në kohë, konfidenciale dhe aktivitete të tjera. Një mentor është përgjithësisht një individ më me përvojë që krijon një marrëdhënie me një person që nuk ka patur lidhje më parë për të ofruar mbështetje, udhëzime dhe inkurajim të vazhdueshëm, për të ndihmuar personin të zhvillojë aftësitë dhe karakterin e tij, të rifitojë kontrollin mbi jetën e tij dhe të realizojë potencialin e tij gjatë procesit të riintegrit. Procesi i mentorimit ka ndikim shumë efektiv në zvogëlimin e izolimit dhe dhënien e mbështetjes emocionale viktimave të dhunës, abuzimit dhe trafikimit gjatë procesit të riintegrit. Nëpërmjet tij rastet që ndjehen të izoluar dhe të stigmatizuara ndihmohen në fusha si ndërtimi i besimit, vetëvlerësimit, rritja e aksesit në burime të tjera të disponueshme dhe rritja e aftësive për të shmangur dhunën, abuzimin dhe shfrytëzimin apo marrëdhënie të dëmshme personale. Aktivitetet që realizohen në kuadër të mentorimit përzgjidhen së bashku me rastet sipas interesave dhe dëshirave të tyre ku përgjithësi këto aktivitete realizohen me qëllim angazhimin, edukimin, informimin edhe relaksimin si dhe argëtimin e tyre.

Eksperienca e D&E

Mentorimi: D&E i ka kushtuar rëndësi të vecantë zhvillimit të mëtejshëm të këtij shërbimi për ta bërë sa më të qëndrueshëm dhe efektiv për viktimat e trafikimit. Për këtë qëllim ***është zhvilluar një modul praktik dhe specifik për mentorimin*** e përfitueseve të organizatës. Bazuar në këtë modul, një trajnim ofrohet për mentorët që përfshihen në shërbimin e mentorimit. Trajnimi ka për qëllim të japë njohuri specifike për llojet e mentorimit, fazat, sfidat që viktimat e trafikimit hasin gjatë procesit të rikuperimit/ riintegrit si dhe nevojat e tyre për mentorim efektiv.

D&E ofron në mënyrë të vazhdueshme supervizim individual dhe në grup për mentorët, në mënyrë që procesi i mentorimit të jetë efektiv për përfituesin dhe mentorin vetë.

Mentorët e ofrojnë mbështetjen në baza javore në përputhje me nevojat e rasteve dhe mënyrave sesi është planifikuar ndërtimi i marrëdhënies dypalëshe. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet aktiviteteve dhe takimeve periodike.

Mentorimi bashkëmohatar: D&E ka ofruar gjithashtu modelin e peer mentoring, mentorit të mbijetuar të dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit për të mbështetur të mbijetuarat e tjera të dhunës, abuzimit apo shfrytëzimit.

Mentorimi bashkëmohatar i referohet angazhimit dhe trajnimit të të mbijetuarave të dhunës, abuzimit apo trafikimit të cilat pasi kanë kaluar në një stad më të avancuar të riintegrit, aftësohen të punojnë si mentore për të mbijetuarat e dhunës, abuzimit apo trafikimit të indentifikuara së fundmi. Ky proces shërben si një marrëdhënie transformuese, pasi kur modeli pozitiv është një e mbijetuar që po rindërton me sukses jetën e saj, katalizatori për ndryshim mund të ketë një efekt edhe më të madh. Ndërveprimet me vajza, gra që kanë kaluar me sukses përvoja të ngjashme i bën të ndihen më komod për të bashkëvepruar si dhe ndihmon të dyja palët si mentorin dhe të mentoruarin të përparojnë për të dalë nga një cikël vuajtjesh duke filluar një rrugëtim të ri. Ky proces ndërkohë synon vendosjen e një marrëdhënie besimi si një mjet i vlefshëm për të ndihmuar në riintegrimin e viktimave të traumatizuara përmes fuqizimit dhe ndjenjës së pranimit. Mentorët ofrojnë mbështetje të vazhdueshme përmes aktiviteteve dhe takimeve të ndryshme në baza javore ose mujore, në varësi të nevojave të mbijetuarave dhe ndërkohë ato janë vazhdimisht nën supervizimin e menaxherëve të rasteve të Organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E).

KREU IV

Ndryshimi i kontekstit

Mjedisi familjar

Mjedisi familjar duhet shqyrtuar me kujdes nga ofruesit e shërbimeve. Ka raste kur familja biologjike mund të ketë qenë shkaktare e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë e dhunës dhe në këtë rast janë vetë të mbijetuarat që refuzojnë (shfaqin rezistencë) në rivendosjen e marrëdhënieve me ta. Në të tilla raste vendimi për të kërkuar ndihmën e familjes për riintegrim është tejet i vështirë pavarësisht se familjet janë shumë herë më mbështetëse dhe kuptojnë situatën në krahasim me komunitetin përreth. Një nga sfidat kryesore në këtë aspekt është të luftohet stigma që haset nga familja dhe shoqëria lidhur me të mbijetuarat e dhunës. Problemet që lidhen me paragjykimet shoqërore janë nga më të ndryshmet. Dhe pavarësisht se familja duhet të luajë rolin e ndërmjetësuesit kundrejt të mbijetuarës së DHBGJ dhe komunitetit, shpeshherë kjo konstatohet që është tejet e vështirë. Për të gjitha këto arsye shërbimet shoqërore në njësinë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile, grupet e grave, udhëheqësit e besimeve dhe të komunitetit duhet të luajnë një rol kyç për mobilizimin e përpjekjeve të komunitetit për rritjen e ndërgjegjësimit për prevalencën e DHBGJ dhe rolin e komunitetit për përgjigjet dhe parandalimin e saj. Kjo arrihet përmes **fushatave ndërgjegjëse periodike nga anëtarët e MKR-së në bashkinë përkatëse** mbi dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore, të drejtat e viktimave dhe shërbimet që janë në dispozicion për to.

Nryshimi tek burrat dhunues

Referuar ndryshimeve të fundit ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, konkretisht nenit 5 (që shton nenin 10/1) të ligjit 125/2020 "Për ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", tashmë dhunuesi duhet t'i nënshtrohet një programi rehabilitimi psikosocial dhe/ose në programe të aftësimi prindëror me qëllim parandalimin e dhunës por edhe riintegrimin e dhunuesit në shoqëri. Ky ligj parashikon edhe Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e këtij programi rehabilitimi.

“Neni 10/1

Rehabilitimi i dhunuesit

1. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, udhërohet dhunuesi të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private.
2. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij në mënyrë periodike dhe rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi nuk merr pjesë në program, përveç rasteve kur ka arsye objektive dhe shkaqe të përligjura për mospjesëmarrjen, me kërkesë të mbledhjes ad-hoc të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes.
3. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, udhërohet i padituri ose dhunuesi, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorie ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, 2 shërbime të alkologjisë ose shërbime të toksikologjisë.
4. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit vënë në dijeni koordinatorin vendor pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij.
5. Një dhunues, i dënuar me vendim gjykate për të kryer dënimin në insitucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mund të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi në program mbahet parasysh në vlerësimin e rrezikut të të dënuarit në rastet e lirimit me kusht, lejeve shpërblyese ose të veçanta, të vizitave.

Kreu V

Partnershipe të rëndësishme për zbatimin e këtij modeli

Institucionet	Bashkëpunimet /partnership
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Policisë	Bashkëpunim për rastet e MDhBGj që kanë denoncuar dhunuesin, për sigurinë e tyre; Shoqërimi i rasteve me probleme sigurie në gjykatë, apo takime të tjera sipas nevojave të tyre;
Gjykata / Prokuroria/ Përmbarimi	Bashkëpunim për rastet e MDhBGj që kanë në proces çështjet penale; Bashkëpunimi në dhënien e informacionit për këto çështje dhe mbarëvajtja e tyre;
Bashkitë / Njësitë Administrative / PMF / Koordinatorët e dhunës	Menaxhimi i rasteve të DHBGJ; Vlerësimi i situatës familjare; Vlerësimi i nevojave; Monitorimi dhe ndjekja e rasteve që jetojnë në komunitet; Mbështetje për regjistrimin e fëmijëve në çerdhet shtetërore/pa pagesë; Lehtësimi i procedurave dhe përfitimi nga programet e strehimit;
Drejtoria Rajonale e Punësimit dhe Qendrat e Formimit Profesional	Regjistrimi i rasteve si punëkërkues; Ofrimi i trajnimit profesional pa pagesë ose me një pagesë të vogël për rastet e DHBGJ në qendrat e formimit profesional; Përfshirja e rasteve në programet e nxitjes së punësimit;
Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe Drejtoritë e shkollave	Regjistrimi i rasteve të DHBGJ dhe i fëmijëve të tyre në sistemin shkollor; Ofrimi i lehtësirave për përgatitjen e dokumentave të nevojshme për regjistrimin e rasteve në sistemin shkollor; Regjistrimi i fëmijëve në kopësht;
Qendrat që ofrojnë ndihmë ligjore	Ofrimi i mbështetjes ligjore për rastet e DHBGJ; Mbështetje në përfaqësimin e rasteve në gjykata;
Bashkëpunim me kompanitë e biznesit	Punësimi i rasteve në kompani biznesi; Mundësi e përfshirjes në programet e trajnimit në vendin e punës (internship); Ndjekja e kurseve profesionale të avancuara për rastet;

Kreu VI

Kostoja e zbatimit të këtij modeli

Zbatimi i planeve socio-ekonomike (në të cilat përfshihen një gamë e gjerë shërbimesh) për të mbijetuarit e DHBGJ sjell një riintegrim të suksesshëm. Këto shërbime në vetvete përmbajnë një kosto të caktuar, kosto të cilat ndahen sipas fazave të riintegrit të cilat fillojnë që nga akomodimi, kujdesi mjekësor, asistencë ligjore, paketa ushqimore, plotësimi nevojave bazike siç janë veshmbathje apo material higjienike, mbështetje për mirërritjen e fëmijëve etj, si dhe mbështetje afatgjata si fuqizimin ekonomik, trainime dhe kurse të ndryshme, programe punësimi, etj.

Shërbimet që ofrohen për të mbijetuarit e DHBGJ janë individuale dhe varen nga nevoja që gjithësecili prej tyre paraqet, nevoja të cilat vlerësohen nga menaxherët e rastit. Këto shërbime ofrohen dhe kostohehen sipas fazave të riintegrit:

Faza I - Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize

Faza II - Asistenca afatmesme. Faza tranzitore e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur.

Faza III - Asistenca afatgjatë. Riintegrimi dhe përfshirja sociale.

Kostot për secilën fazë mund ti grupojmë në dy kategori:

Kosto Direkte në të cilat përfshihen kostot e bëra për shpenzime individuale të rastit siç mund të jenë ushqimi, shërbimet shëndetësore, trajnime, mbështetje financiare për qera apartamenti, etj

Kostot Indirekte në të cilat përfshihen kosto që bëhen për programin në përgjithësi por nga të cilat përfitojnë të gjitha përfitueset edhe pse jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe individuale si p.sh. pagesat e stafit, transporti, amortizimi i materialeve, etj.

Në tabelat e mëposhtme jepet një përshkrim më i detajuar i kostove sipas fazave të riintegrit për shërbime të caktuara që i ofrohen për riintegrimin një të mbijetuarit të dhunës me bazë gjinore.

Faza I- Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize. Periudha deri në 6 muaj per 1 perfitues me një fëmijë.

Shërbimet e Ofruara	Kosto	Përshkrimi i Shërbimit
Strehim dhe akomodim në strehëz	65,635 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen qera strehëza, energji, ujë, ngrohje, mirëmbajtje, krevat, dollap etj
Ruajtje dhe siguri fizike në Shellter	77,280 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen shërbimi 24 ore i rojeve për ruajtjen dhe sigurinë fizike
Ushqime	93,600 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen ushqimi sipas kuotës të shpenzimit standart sipas legjislacionit në fuqi
Veshje dhe materiale personale të nevojshme	47,340 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen veshje të ndryshme, veshmbathje, materiale të kujdesit personal etj
Mbështetje për mirërritjen e fëmijëve	35,780 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen, veshje, kujdesi personal, pagesë kopështi, libra etj për fëmijën/t
Shërbim mjekësor	30,400 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen medikamente, analiza, shërbim dentar, shërbim gjinekologjik, mjekësor etj
Asistencë ligjore	25,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen dokumenta të ndryshme si aplikimi për ID, për bonus qera, për çështje gjyqësore, paga e avokatit etj
Asistencë Psiko-Sociale	90,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen kostot e seancave të ndërhyrjes në krizë dhe stabilizimi. Kryhen 20 seanca me kosto 3.000 leke seanca per te rritur, dhe kostoja per femije 1.500 leke seanca
Transport	22,900 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen shërbimi i transportit për shoqërimin në aktivitete të ndryshme, shkollë, etj
Shkollimi, Trainime dhe kurse të ndryshme	8,900 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen trainime dhe kurse të ndryshme të cilat zhvillohen në grup si art terapi, kurse kompjuteri etj
Aktivitete Sociale	3,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen aktivitete të brendëshme dhe të jashtme eskursione, aktivitete sportive, kinema, dalja për pazar, vizita në pika turistike
Kosto indirekte	35,026 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen një përqindje të kostove të stafit, dhe shpenzime të tjera administrative

Faza II - Asistenca afatmesme. Faza tranzitore e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur. Periudha deri në 1 Vit

Shërbimet e Ofruara	Kosto	Përshkrimi i Shërbimit
Mbështetje Financiare për qera Apartamenti	90,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen qera e apartamentit për një periudhë 1 vjecare
Ushqime	15,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen mbështetja me paketa ushqimore për 3-4 muaj
Veshje dhe materiale personale të nevojshme	8,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen veshje të ndryshme, materiale të kujdesit personal etj
Mbështetje për mirërritjen e fëmijëve	7,500 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen, veshje, kujdesi personal, pagese kopeshti, libra etj per femijen
Shërbim mjekësor	10,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen medikamente, analiza në raste emergjence, etj
Asistence ligjore	12,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen dokumenta të ndryshme për bonus qera, për çështje gjyqësore, etj
Asistencë Psiko-Sociale	28,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen kostot e seancave të suportim, fuqizim dhe rritje individuale. Kryhen 8 seanca me kosto 2,500 lekë seanca për të rritur, dhe kostoja për fëmijë 1.000 leke seanca
Transport	9,600 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen shërbimi i transportit abone mujore, etj
Shkollimi Trainime dhe kurse të ndryshme	65.000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen kurse të ndryshme dhe trainime profesionale të cilat zhvillohen për 3 muaj.
Programe punësimi për 3 muaj	106.692 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen punësimi për tre muaj në një biznes ku i paguhet paga+sigurime, program intership
Kosto indirekte	15,834 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen një përqindje të kostove të stafit, dhe shpenzime të tjera administrative

Faza III- Asistenca afatgjatë.Riintegrimi dhe përfshirja sociale.

Periudha deri ne 3 Vjet

Shërbimet e Ofruara	Kosto	Përshkrimi i Shërbimit
Asistence Psiko-Sociale	7,500 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen kostot e seancave të monitorimit. Kryhen 5 seanca me kosto 1,500 lekë seanca
Fuqizim Ekonomik	250,000 Lekë	Në këtë shërbim përfshihen shpenzimet për hapjen e një mikrobiznesi, plotësim dokumentacioni, marrja e një ambjenti me qera, blerja e mjeteve të punës etj

Faza I - Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize. Kosto për një përfituese me një fëmijë për gjashtë muaj është në vlerën 534,861 Lekë.

Faza II - Asistenca afatmesme. Faza tranzitore e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur. Kosto për një përfituese me një fëmijë është në vlerën 367,626 Lekë.

Faza III - Asistenca afatgjatë. Riintegrimi dhe përfshirja sociale. Kosto për një përfitues është në vlerën 257,500 Lekë.

KREU VII

Dokumentacioni dhe formate të rëndësishme në zbatimin e modelit të riintegritimit

Aneks 1

Formatet e vlerësimit të nevojave të rastit

Vlerësimi i Nevojave

- Vlerësimi i Sigurisë
- Vlerësimi i Akomodimit
- Vlerësimi Ligjor
- Vlerësimi Shëndetësor
- Vlerësimi Psiko-social
- Vlerësimi i Familjes (Kërkohe vetëm për të miturit, por mund të përfshihet për të rriturit nëse dëshirohet nga përfituesi)
- Vlerësimi i Arsimit
- Vlerësimi Profesional / Punësimi

Formularët e Vlerësimit të Nevojave

Vlerësimi i Nevojave – Siguria

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

Rreziqet e lidhura me Përfituesin

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Akomodim Afat-Gjatë

Emri i Përfitueses: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Ligjore

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Shëndeti

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Psiko-Sociale

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Familja

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Arsimimi (16+)

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit:

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin:

1) Moshë e Përfituesit: _____

2) A dëshiron përfituesi të vazhdojë shkollën?

3) Viti i fundit shkollor që është përfunduar:

- 4) Numri i viteve shkollore që përfituesi ka humbur:
- 5) A ka programme të disponueshme për të ndihmuar përfituesin që të zëvendësojë vitet e humbura shkollore me qëllim që të arrijë bashkëmoshatarët?
- 6) A ka përfituesi probleme sigurie që mund të ndikojnë mbi aftësinë e tyre për të shkuar në shkollën lokale? Nëse po, çfarë masash alternative janë të mundshme?
- 7) Nëse përfituesi është tashmë në shkollë, si po përparon? Çfarë ndihme shtesë kërkon (mbikqyrje, vend i qetë për detyrat e shtëpisë, libra dhe materiale, etj.)?

_____ 0 _____ 0 _____

Vlerësimi i Nevojave – Profesional / Punësimi

Emri i Përfituesit: _____

Data e Vlerësimit: _____

Emri i Personit që Plotëson Formularin: _____

Pozicioni i Personit që Plotëson Formularin: _____

ANEKS 2

MARRËVESHJE MBI BASHKËPUNIMIN ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E PLANIT TË REINTEGRIMIT

E lidhur sot më datë

MES INSTITUCIONIT

DHE

INDIVIDIT.....

DHE

KUJDESTARIT.....

DHE

PALË TË INTERESUARA.....

PALËT BIEN DAKORD QË:

1. QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i marrëveshjes është përcaktimi i veprimeve, përgjegjësive dhe financimit të riintegrit të individit

2. PËRKUFIZIMET

Reintegrimit është një proces i mbështetjes profesionale multidimensionale dhe arritjes së shëndetit dhe mirëqenies së plotë të një individi pas eksperincave të dhunës me bazë gjinore. Etapat / fazat janë: 1. Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize; 2. Asistenca afatmesme. Tranzicioni; 3. Asistenca afatgjatë dhe përfshirja sociale

3. PARIMET E BASHKËPUNIMIT

- Besimi i ndërsjellë;
- Njoftimi i menjëhershëm për pamundësi të zbatimit të marrëveshjes;
- Zbatimi i ligjit
- Ruajtja e privatësisë, konfidencialitetit;
- Rishikimi i marrëveshjes sa here që është e nevojshme

4. FINANCIMI I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Zbatimi i kësaj marrëveshje mbështetet nga financimi i

a).....

b).....

Individi do të njoftohet nga Institucioni për ndryshime në financim

5. VLERËSIMI , PLANI DHE RISHIKIMI I PLANIT

- Plani i rintegritit i parë hartohet mbi bazën e vlerësimit të parë. Vlerësimi i parë kryhet nga individi dhe ekipi multidisiplinar i kryesuar nga punonjësi kyç.

6. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje është e vlefshme nga data e vendosjes deri në datën e fundit të vendosur në afatet e veprimeve. Çdo rishikim i planit të veprimeve të riintegritit do të shoqërohet me amendim të marrëveshjes.

ANEKSE

A. VLERËSIMI I-rë I SITUATËS SË RIINTEGRIMIT

B. PLANI I-rë I VEPRIMEVE TË RIINTEGRIMIT

Faza I Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize

Objektivat:

Mbështetje	Veprimet specifike	Koha e fillimit	Përgjegësia e individit	Përgjegësia e menaxherit të rastit	Përgjegësia e palëve të treta	Elementët e kostos të përfshira	Kostot	Kriteret e përfundimit me sukses
Siguria								
Shëndeti fizik								
Shëndeti emocional dhe mendor								
Situata ekonomike								
Situata Sociale								
Situata familjare								
Strehimi								
Shëndeti ligjor								
Aftësitë për jetën								
Edukimi Profesional								
Arsimi								
Punësimi								
Të ardhurat								
Planet për të ardhmen								

Faza II: Asistenca afatmesme. Tranzicioni

Objektivat :

Mbështetja	Veprimet specifike	Koha e fillimit	Përgjegjësia e individit	Përgjegjësia e menaxherit të rastit	Përgjegjësia e palëve të treta	Elementët e kostos të përfshira	Kostot	Kriteret e përfundimit me sukses
Siguria								
Shëndeti fizik								
Shëndeti emocional dhe mendor								
Situata ekonomike								
Situata Sociale								
Situata familjare								
Strehimi								
Shëndeti ligjor								
Aftësitë për jetën								
Edukimi Profesional								
Arsimi								
Punësimi								
Të ardhurat								
Planet për të ardhmen								

Faza III : Asistenca afatgjatë dhe përfshirja sociale

Objektivat :

Mbështetja	Veprimet specifike	Koha e fillimit	Përgjegjësia e individit	Përgjegjësia e menaxherit të rastit	Përgjegjësia e palëve të treta	Elementët e kostos të përfshirja	Kostot	Kriteret e përfundimit me sukses
Siguria								
Shëndeti fizik								
Shëndeti emocional dhe mendor								
Situata ekonomike								
Situata Sociale								
Situata familjare								
Strehimi								
Shëndeti ligjor								
Aftësitë për jetën								
Edukimi Profesional								
Arsimi								
Punësimi								
Të ardhurat								
Planet për të ardhmen								

Individi: _____
Emri Firma Data

Përfaqësuesi i institucionit: _____
Emri Firma Data

Prindi / Kujdestari i Individit: _____
Emri Firma Data

ANEKS 3.

KORNIZA E PLANIT TË RI-INTEGRIMIT PER BASHKITË

Procesi i hartimit të Planit

- Krijimi i një grupi pune me pjesëmarje nga ETN
- Rishikimi i kornizës së planit dhe përzgjedhja e veprimeve nga grupi i punës
- Përgatitja e planit
- Shqyrtimi i planit

Baza Ligjore

Ligji nr.9970 datë 28.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar

Ligji 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”

Udhëzimi Nr. 816, datë 27.11.2018, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e standarteve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të Qendrave të menazhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”

Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm Nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”,

Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”

Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 9, datë 17.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”

Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”

Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në RSH”

Ligji 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH”

Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,

Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”

Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Ligji 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale”

Ligji 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës”

Ligji 22/2018 “Për strehimin social”,

Ligji 110/2018 “Për noterinë”,

Ligji 111/2018 “Për kadastrën”,

Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit

Ligji 57/2019 “Për asistencën sociale në RSH”

Ligji 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara

Ligj nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të Huajt”

VKM nr. 789 datë 26.12.2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale”

VKM nr. 716, datë 1.12.2017 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”

VKM nr. 16, datë 12.1.2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”
VKM Nr. 535, Procedurat kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet

VKM Nr. 17, datë 15.1.2020 “Për Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”

Parime të hartimit dhe zbatimit të planit

- Aplikimi i një qasjeje që merr në konsideratë dhe harmonizon rolet përgjegjësitë dhe burimet e sektorëve të ndryshëm, niveleve të ndryshme, të institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile, institucioneve fetare, ndërmarrjeve private etj.;
- Pjesëmarrja aktive dhe e qenësishme e komuniteteve, shoqërisë civile, lëvizjeve dhe personave më të prekur në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planit;
- Marrja parasysh e pabarazive dhe dallimeve gjinore që nxisin dhe mundësojnë dhunën me bazë gjinore përfshirë nevojën që burrat të mbështeten në ndryshimet e nevojshme;
- Aplikimi i një qasjeje të bazuar te të drejtat e njeriut, të përqëndruar te të mbijetuarit për ofrimin e shërbimeve te të gjithë, pavarësisht nga mundësitë financiare;
- Përfshirja dhe përfaqimi i diversitetit

Qëllimi

Krijimi dhe funksionimi i një konteksti social dhe ekonomik që lehtëson reintegrimin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe parandalon viktimizimin

Objektiva

- Sigurimi i një përgjigjeje të menjëhershme dhe të qëndrueshme ndaj nevojave të riintegrit të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore
- Ndryshimi i normave dhe sjelljeve shoqërore
- Krijimi i më shumë mundësive ekonomike për gratë që janë të cënueshme ndaj abuzimit për shkak të varfërisë
- Sigurimi dhe zgjerimi i aksesit në drejtësi
- Forcimi i llogaridhënies së aktorëve

Shtyllat e ndërhyrjes

A. Krijimi i kontekstit /krijimi i sistemit funksional të aksesueshëm

B. Mbështetja e individëve dhe familjeve

Akronime

AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
SMNJVV	Agjencia për Mbështetjen e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
KKBGJ	Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore
LGBTQIA+	lesbian, gay, bisexual, transgender, queer, intersex, and asexual
LGBTQQIP2SAA	lesbian, gay, bisexual, transgender, questioning, queer, intersex, pansexual, tëo-spirit (2S), androgynous and asexual
ISHPSHSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
NJPF	Ndihma Juridike Parësore Falas
NJDF	Ndihma Juridike Dytësore Falas
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Fjalorth

“Dhunë me bazë gjinore ndaj grave” do të thotë dhunë që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale¹⁹

“Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjisllacionit në fuqi.²⁰

“Dhuna ndaj grave” është një shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë ose mund të rezultojnë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtjet e grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private²¹

“Dhunë në familje” do të thotë të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë familjare ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve të mëparshëm ose aktualë, pavarësisht nëse dhunuesi ndan ose nuk ndan të njëjtën banesë me viktimën²²

“Gjini” do të thotë rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat²³

“Fuqizimi ekonomik” Banka Botërore e përkufizon fuqizimin ekonomik të grave si “bërja e tregjeve funksionale për gratë dhe fuqizimi i grave për të konkurruar në tregje”²⁴

“Dhuna në internet” i referohet çdo akti dhune me bazë gjinore ndaj një gruaje që kryhet, ndihmohet ose rëndohet pjesërisht ose plotësisht nga përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), si telefonat celularë dhe telefonat inteligjentë, interneti, platformat e mediave sociale ose email, kundër një gruaje sepse ajo është një grua, ose ndikon grate në mënyrë disproporcionale²⁵

¹⁹ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

²⁰ Ligj nr. 18/2017 Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës

²¹ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

²² Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

²³ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

²⁴ Maria Elena Ruiz, Abril, “Politika Ekonomike të Duhura për Gratë në Shqipëri Policy Issues and options for Women’s Economic Empowerment” A Policy Issues Paper , UN WOMEN 2012

²⁵ Human Rights Council A/HRC/38/47 Report of the Special Rapporteur on violence against women its causes and consequences on online violence against women and girls from a human rights perspective – Advance edited version 14 June 2018

Viktima në qendër: Një qasje e përqendruar te viktima është fokusimi sistematik në nevojat dhe shqetësimet e një viktime për të siguruar ofrimin e dhembshur dhe të ndjeshëm të shërbimeve në një mënyrë jo-gjyquese. Ai synon të minimizojë traumatizimin e lidhur me proceset e drejtësisë penale duke ofruar mbështetje për avokatët e viktimave dhe ofruesit e shërbimeve, duke fuqizuar të mbijetuarit si pjesëmarrës të angazhuar në proces dhe duke u ofruar të mbijetuarve një mundësi për rol në sjelljen para drejtësisë së shkelësve²⁶

Reintegrimi është një proces i mbështetjes profesionale multidimensionale dhe arritjes së shëndetit dhe mirëqenies së plotë të një individi pas eksperiencave të dhunës me bazë gjinore. Etapat / fazat janë: 1. Asistenca fillestare. Ndërhyrja në situatë krize; 2. Asistenca afatmesme. Tranzicioni; 3. Asistenca afatgjatë dhe përfshirja sociale

“Dhuna ndaj grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë ose mund të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtje të grave, duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike ose private²⁷

²⁶ <https://www.ovcttac.gov/taskforceguide/eguide/1-understanding-human-trafficking/13-victim-centered-approach/> 26 Adapted from ISCPs

²⁷ Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence

MATRICA E PLANIT

Shtylla A. Krijimi i kontekstit /krijimi i sistemit të aksesueshëm dhe të matshëm

Veprimet	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Projekte me te cilat mund te harmonizohet veprimi/ose te integrohet në to	Treguesit e realizimit
Krijimi i një grupi pune për planin						
Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit të ofruesve të shërbimeve						
Përzgjedhja e ofruesve të shërbimit						
Lidhja e marrëveshjeve me partnerët e munshëm (social biznesi)						
Monitorimi i shërbimit të ofruar						
Ngritja dhe mbajtja funksionale e qendrës së emergjencës						
Koordinimi mes mekanizmave						
Trejnimet e vazhduara të profesionistëve						
Krijimi i sistemit të shkëmbimit						

Veprimet	Përgjegjësi kryesor	Afatet kohore	Elementët e kostos	Kosto në lekë	Projekte me te cilat mund te harmonizohet veprimi/ose te integrohet në to	Treguesit e realizimit
dhe përditësimi të informacionit mbi projektet shërbimet aktorët						
Ndërgjegjësimi mbi dhunën efektet shërbimet						
Sigurimi i logjistikës për punë jashtë orarit të punonjësve socialë të bashkisë						
Krijimi i programeve të kujdesit pas shkolle (kur nena eshte ne pune)						

Shtylla B. Mbështetja direkte e individëve dhe familjeve

Veprimet	Përgjegjësi kryesor	Përfituesi (t)	Afatet kohore në faza reintegrimi	Elementët e kostos	Kosto në lekë për individ familje ose njësi kohore	Treguesit
Strehimi i menjëhershëm i sigurt në qendër				Stafi i sigurisë Stafi i		

Veprimet	Përgjegjësi kryesor	Përfituesi (t)	Afatet kohore në faza reintegrimi	Elementët e kostos	Kosto në lekë për individ familje ose njësi kohore	Treguesit
				kujdesit		
Transporti në vend të sigurt				Transporti Shoqërimi		
Konsultim me psikologun						
Konsultim ligjor						
Transport në takime						
Ekzaminime, trajtim mjekësor						
Mbështetje për problemet ligjore						
Mbështetje për problemet psikologjike						
Aktivitete jashtëshkollore hobe interesa për fëmijët						
Strehim I pavarur						
Këshillim për punësim						
Subvencionim i transportit ne pune						
Kontrolli mbi dokumentacionin						
Mbështetje per takime me peers						
Mbështetje per ankesa						

KREU VIII

Baza ligjore e Modelit

Ligji nr. 121, datë 21.11.16, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”;

Ligji nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;

Ligji nr. 22, datë 03.05.2018”, Për strehimin social”;

Ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në RSH”;

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, 47/2018, datë 23.7.2018,125/2020 datë 15.10.2020);

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;

VKM nr.195, datë 11.04.2007, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”;

VKM nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij”;

VKM nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” ;

VKM nr. 505, datë 13.7.2011, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”;

VKM nr. 569, datë 03.10.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në RSH”;

VKM nr. 956, datë 07.12.2016, “Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike”;

VKM nr. 597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”;

VKM nr. 499, datë 29.08.2018, “Për miratimin e Procedurave Standarte të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;

VKM nr. 27, datë 11.1.2012, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, (ndryshuar me VKM nr. 178, datë 28.3.2018)”;

VKM nr. 48, datë 16.1.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi”, të ndryshuar.”(ndryshuar me VKM nr.189 datë 02.04.2014)

VKM nr. 47, datë 16.1.2008, “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”, të ndryshuar.”(ndryshuar me VKM nr.993, datë 2.7.2008, nr.683, datë 5.10.2011, nr. 775, datë 7.11.2012, nr. 193, datë 2.4.2014, nr. 458, datë9.7.2014 , nr. 65, datë 27.1.2016);

VKM nr.873, datë 27.12.2006, “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuësit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”.”(Ndryshuar me VKM nr.187, datë 2.4.2014);

VKM nr.248, datë 30.04.2014, “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara”, (ndryshuar me VKM nr. 460, datë 9.7.2014);

Udhëzim nr. 316, datë 10.02.2010, “Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi” ;

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”;

Udhëzim nr.911, datë 27.12.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumë-disciplinore”;

Udhëzim i përbashkët, nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrimit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”;

Udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale”

Udhëzim nr. 744, datë 15.11.2019 “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jo-publike (strehëzat emergjente)”;

Urdhër nr. 101, datë 21.2.2020 “Për miratimin e procedurave standarte të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR)”;

Urdhër nr. 78, datë 04.04.2006, “Për Tarifat e Sistemit të Formimit Profesional”;

Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës seksuale tek të rriturat /rriturit, në nivel vendor perms qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, Prill 2019;

Protokolli i Menaxhimit të Rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, perms mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR);